

Vaksinimi për mbrojtjen kundër HPV

Informacion për prindërit dhe personat që kualifikohen për vaksinimin plotësues kundër HPV

Rreth programit të vaksinimit plotësues kundër HPV-së "Laura Brennan"

Në muajin dhjetor 2022, Ministri i Shëndetësisë njoftoi një program vaksinimi plotësues kundër HPV-së. Programit iu vendos emri në kujtim të Laura Brennan, e cila mbrojti pa u lodhur vaksinimin kundër HPV-së përpara se të vdiste nga kanceri i qafës së mitrës në mars 2019. HSE po ofron një mundësi **vetëm një herë** për personat që kualifikohen, që të bëjnë vaksinën e tyre plotësuese kundër HPV-së. Vaksina është e sigurt, efektive dhe pa pagesë. Ajo do të ofrohet vetëm deri në fund të vitit 2023.

Rreth kësaj broshure

Kjo broshurë është për prindërit, nxënësit dhe nxënëset dhe personat që kualifikohen për të marrë vaksinën plotësuese kundër HPV-së. Shpresojmë që prindërit dhe nxënësit dhe nxënëset ta lexojnë së bashku.

Ekipet e vaksinimit të HSE-së po ofrojnë vaksina plotësuese kundër HPV-së për:

Nxënësit e mëposhtëm ende në shkollë të mesme – si djem ashtu edhe vajza – të cilët nuk e kanë marrë tashmë vaksinën kundër HPV-së:

› Nxënëset femra në vitin 2 – 6 të shkollës së mesme, shkollës shtëpiake ose shkollës speciale

› Nxënësit meshkuj në vitin 2 – 6 të shkollës së mesme, shkollës shtëpiake ose shkollës speciale

Të gjitha femrat që kanë lënë arsimin e nivelit të dytë dhe janë nën 25 vjeç në datën e vaksinimit, me kusht që të mos e kenë marrë më parë vaksinën

Të gjithë meshkujt që kanë lënë arsimin e nivelit të dytë dhe janë nën 22 vjeç në datën e vaksinimit, me kusht që të mos e kenë marrë më parë vaksinën.

(Për shënim: Studentet e huaja femra të pavaksinuar nën 25 vjeç dhe studentët e huaj meshkuj të pavaksinuar nën 22 vjeç, që janë rezidentë* të zakonshëm në Irlandë për qëllime të marrjes së shërbimeve shëndetësore, konsiderohen gjithashtu të pranueshëm për vaksinimin kundër HPV-së sipas programit plotësues).

Refugjatët dhe aplikantët e kërkesës për mbrojtje në Irlandë, të cilët janë në gjininë dhe moshën ekuivalente me grupet e listuara më sipër, konsiderohen gjithashtu të pranueshëm për vaksinimin plotësues kundër HPV-së, sipas programit të vaksinimit plotësues të HPV "Laura Brennan" – me kusht që të mos e kenë marrë më parë vaksinën kundër HPV-së.

*Ju konsideroheni rezident i zakonshëm nëse keni të paktën një vit që jetoni në Irlandë apo nëse planifikoni të jetoni këtu të paktën një vit. Për më shumë informacion, ju lutemi vizitoni Citizens Information në adresën <https://www.citizensinformation.ie/en/health/health-system/entitlement-to-public-health-services/>

Personave që kualifikohen për vaksinën kundër HPV-së do t'u ofrohet:

Një dozë vaksine nëse kanë një sistem imunitar të shëndetshëm ose

Tre doza vaksine nëse janë të immuno-komprometuar (kanë sistem imunitar të dobët).

Nëse fëmija juaj është 15 vjeç ose më i vogël, ne kemi nevojë që prindërit dhe kujdestarët të lexojnë këtë informacion dhe të japin pëlqimin për të treguar se janë dakord që fëmija i tyre ta bëjë këtë vaksinë.

Personat 16 vjeç e lart mund ta japin vetë pëlqimin për veten e tyre. Nëse jeni në moshën 16 deri në 24 vjeç, ne kemi nevojë që njerëzit të lexojnë këtë informacion dhe të japin pëlqimin për të treguar se janë dakord ta bëjnë këtë vaksinë.

Kjo broshurë përmban informacionet më poshtë:

vaksina kundër HPV-së – nga çfarë mbron dhe dozat e nevojshme

vizitat e ekipeve të vaksinimit

Albanian

Vaccination to protect against HPV

Information for parents and people eligible for catch-up HPV vaccination

- pyetjet më të zakonshme
- ku mund të gjeni më shumë informacione
- dhënia e pëlqimit

Nëse keni pyetje në lidhje me ndonjë pjesë të kësaj broshure, kontaktoni një anëtar të ekipit të vaksinimit. Të dhënat e kontaktit do t'i gjeni në www.hpv.ie

Vaksina kundër HPV-së

Vaksina është një substancë që krijon imunitet (mbrojtje) ndaj një sëmundjeje të veçantë.

Vaksina kundër HPV-së mbron nga virusi HPV i cili mund të shkaktojë kancer.

Vaksinimi

Ekipet e imunizimit të HSE-së do ta bëjnë vaksinën kundër HPV-së në shkollë ose në një klinikë imunizimi. Shumicës së njerëzve u nevojitet vetëm për 1 dozë e vaksinës kundër HPV-së për t'u mbrojtur. Për personat që janë të imuno-komprometuar (kanë sistem imunitar të dobët), nevojiten 3 doza të vaksinës kundër HPV-së.

- Doza 1
- Doza 2 jepet rreth 2 muaj më vonë
- Doza 3 rreth 6 muaj më vonë (d.m.th. 4 muaj pas dozës 2)

Nëse keni përfunduar shkollën, do të ftoheni të vaksinoheni në një klinikë të HSE-së. Vaksina bëhet në krah.

Vaksina kundër HPV-së – më shumë informacione

Çfarë është HPV?

HPV është shkurtim i termit 'human papillomavirus' (virusi i papilomës njerëzore), i cili është një grup që përfshin më shumë se 100 viruse. Virusit HPV është shumë i zakonshëm; shumica e njerëzve do të infektohen me një formë të HPV gjatë jetës së tyre. Ju mund të merrni virusin HPV duke qenë seksualisht aktiv me një person tjetër që tashmë e ka virusin. Shumica e infeksioneve HPV largohen vetë dhe nuk kanë nevojë për trajtim. Megjithatë, në disa njerëz, infeksioni HPV mund të vazhdojë dhe të shkaktojë kancer. HPV shkakton gjithashtu lytha në organet gjenitale.

Vaksina HPV mbron kundër kancerit të qafës së mitrës dhe llojeve të tjera të kancerit. Vaksina kundër HPV-së quhet Gardasil 9.

Pse vaksina kundër HPV-së u bëhet vajzave dhe djemve?

Vaksina kundër HPV-së u ofrohet vajzave në vitin e parë të shkollës së mesme që nga viti 2010. Kjo, sepse kanceri më i zakonshëm i shkaktohet nga virusi HPV është kanceri cervikal – kanceri i qafës së mitrës. Megjithatë, virusi HPV mund të shkaktojë kancere dhe kushte të tjera që mund të prekin djemtë dhe burrat, dhe që nga shtatori 2019, vaksina kundër HPV-së u ofrohet gjithashtu edhe djemve.

Kur infeksionet HPV nuk largohen vetë, ato mund të shkaktojnë rritjen e llojeve të caktuara të kancerit. Te meshkujt, këto përfshijnë:

- Kanceri orofaringeal (kanceret e gojës dhe fytit)
- Kanceri i penisit
- Kanceri anal

Sa më shumë të rinj të vaksinohen – si djem, ashtu edhe vajza – aq më mirë mund të kontrollohet përhapja e infeksionit.

Cilat shtete e bëjnë vaksinën kundër HPV-së?

Mbi 140 shtete dhe territore tani e japin vaksinën kundër HPV-së si pjesë të kalendarit të tyre kombëtar të vaksinimit, ku më shumë se 50 prej këtyre shteteve e japin vaksinën për djemtë dhe vajzat. Në këto shtete përfshihen:

Albanian

Vaccination to protect against HPV

Information for parents and people eligible for catch-up HPV vaccination

- [Australia](#)
- [Zelanda e Re](#)
- [Norvegjia](#)
- [Mbretëria e Bashkuar](#)
- [SHBA](#)

Më shumë informacione rreth suksesit të këtyre programeve jepen në faqen e internetit www.hpv.ie

Ky vaksinim plotësues kundër HPV-së u ofrohet djemve, vajzave, meshkujve më të rritur deri në moshën 22 vjeç dhe femrave më të rritura deri në moshën 25 vjeç.

Vaksina kundër HPV-së jepet në 140 shtete për të parandaluar disa lloje kanceri.

Çfarë llojesh kanceri mund të shkaktojë HPV?

Virusi HPV mund të shkaktojë një sërë lezionesh parakanceroze - qeliza anormale - si te burrat, ashtu edhe te gratë. Pothuajse 10 nga 10 raste të kancerit të qafës së mitrës shkaktohen nga HPV.

Llojet me rrezik të lartë të HPV shkaktojnë gjithashtu rreth:

- 5 nga 10 kancere të vulvës
- 6 nga 10 kancere të gojës dhe fytit (kanceret orofaringeale)
- pothuajse 7 nga 10 kancere të vaginës
- 9 nga 10 kancere të anusit
- pothuajse 4 nga 10 kancere të penisit

Mbi 550.000 studentë në Irlandë dhe 100 milionë njerëz në mbarë botën kanë marrë vaksinën kundër HPV-së.

HPV shkakton 1 në 20 kancere në mbarë botën.

Sa doza të vaksinës HPV nevojiten?

Komiteti Këshillues Kombëtar i Imunizimit (NIAC) ka nxjerrë këshilla të përditësuara në lidhje me numrin e dozave të nevojshme të vaksinës kundër HPV-së.

NIAC tani rekomandon:

- Një dozë** të **vaksinës kundër HPV-së** për personat e moshës 9-24 vjeç
- Dy doza** të **vaksinës kundër HPV-së** për ata të moshës mbi 25 vjeç
- Tre doza** të **vaksinës kundër HPV-së** për personat që janë të **imuno-komprometuar** (d.m.th. kanë sistem imunitar të dobët)

Viti i parë në shkollën e mesme (ose sa më shpejt të jetë e mundur pas vitit të parë) është koha më e mirë për të bërë vaksinën, pasi ajo është më efektive nëse bëhet në këtë moshë.

Pyetjet më të zakonshme

A munden nxënësit e vitit të parë të shkollës së mesme të vendosin të presin dhe ta marrin vaksinën kundër HPV-së më vonë si pjesë e këtij programi të vaksinimit plotësues?

Nxënësve që tani janë në vitin e parë të shkollës së mesme u është ofruar vaksinimi kundër HPV-së këtë vit si pjesë e programit rutinë të vaksinimit në shkollë.

Këtyre nxënësve nuk do t'u ofrohet vaksinimi i mëvonshëm plotësues kundër HPV-së.

Nëse vendosni të prisni derisa fëmija juaj të rritet për t'u vaksinuar, do t'ju duhet të vaksinoni fëmijën tuaj nëpërmjet mjekut tuaj të përgjithshëm (mjeku i familjes) dhe do t'ju duhet të paguani një tarifë administrimi dhe për vaksinat.

Programi i vaksinimit plotësues kundër HPV "Laura Brennan" është një mundësi e vetme për femrat dhe meshkujt deri në një moshë të caktuar që nuk e kanë marrë më parë vaksinën kundër HPV-së, që ta marrin atë tani.

Albanian

Vaccination to protect against HPV

Information for parents and people eligible for catch-up HPV vaccination

A ka një afat për këtë ofertë?

Po. Kjo ofertë do të jetë e disponueshme vetëm deri në fund të vitit 2023.

A munden njerëzit që kanë marrë më parë vaksinën HPV2 (Cervarix) ose HPV4 (Gardasil 4), të marrin tani vaksinën HPV9 që ofrohet në këtë program plotësues?

Jo, nëse keni marrë një cikël vaksinimi HPV2 ose HPV4 në të kaluarën, nuk keni nevojë të rivaksinoheni tani me vaksinën HPV9.

A do të regjistrohen vaksinat që kam marrë?

Po. Në ditën e vaksinimit, pasaportat e vaksinimit do të përditësohen nga ekipi i vaksinimit të shkollës. Nëse nuk keni pasaportë vaksinimi, një anëtar i ekipit të vaksinimi do t'ju japë një të tillë pas vaksinimit.

Si mund të përgatiten nxënësit/unë për ditën e vaksinimit?

Në ditën e vaksinimit, nxënësit duhet:

- Të hanë mëngjes
- Të veshin një bluzë të lirë me mëngë të shkurtra

Nga ta dimë që vaksinat janë të sigurta?

Të gjitha vaksinat janë të sigurta dhe kanë vërtetuar se shpëtojnë jetë dhe parandalojnë sëmundje të rënda. Vaksinat monitorohen rreptësisht dhe rishikohen rregullisht nga organet ndërkombëtare duke përfshirë:

- Organizatën Botërore të Shëndetësisë
- Agjencinë Evropiane të Barnave
- Qendrat për Kontrollin dhe Parandalimin e Sëmundjeve në SHBA

Të gjitha organizmat ndërkombëtare kanë raportuar në vazhdimësi se vaksinat e përdorura në Irlandë janë të sigurta, pa efekte anësore afatgjata të njohura.

A ka vakcina kundër HPV-së efekte anësore afatshkurtra?

Shumica e njerëzve nuk kanë asnjë problem pas vaksinës kundër HPV-së. Disa mund të kenë një vend që i dhemb, ënjtje dhe skuqje në krahun e tyre, aty ku është bërë injeksioni. Disa mund të kenë dhimbje koke, të ndihen të sëmurë në bark ose të kenë një temperaturë të lehtë. Kjo zakonisht kalon pas një ose dy ditësh.

A ka vakcina kundër HPV-së efekte anësore afatgjata?

Nuk ka asnjë efekt anësor afatgjatë të dokumentuar të vaksinës kundër HPV-së.

A duhet të marrin pjesë njerëzit në ekzaminimin e qafës së mitrës nëse janë vaksinuar?

Po. Edhe pse vakcina kundër HPV-së mbron nga shumica e kancereve të qafës së mitrës, ajo nuk mbron nga të gjithë. Prandaj, është ende e rëndësishme që gratë dhe personat me qafë mitre të marrin pjesë në ekzaminimin e qafës së mitrës për HPV sa herë që ftohen. Ekzaminimi i qafës së mitrës për HPV është falas për moshën 25-65 vjeç. Më shumë mund të lexoni në [hse.ie/cervicalcheck](https://www.hse.ie/cervicalcheck)

Çfarë duhet të marr me vete nëse vaksinohem në një klinikë të HSE?

Nëse do të vaksinoheni në një klinikë vaksinimi, duhet të keni me vete dokument identifikimi që tregon datën e lindjes dhe fotografinë tuaj. Kjo mund të jetë pasaporta juaj ose patenta e drejtimit.

Ku mund të merrni më shumë informacion

Nëse keni ndonjë pyetje, ju lutemi ta diskutoni me një anëtar të ekipit të vaksinimit të HSE-së, me infermierën tuaj ose me mjekun tuaj të përgjithshëm (mjeku i familjes).

Mund të vizitoni www.hpv.ie dhe www.immunisation.ie për video dhe fakte rreth vaksinave.

Albanian

Vaccination to protect against HPV

Information for parents and people eligible for catch-up HPV vaccination

Gjithashtu mund të gjeni lidhje për në broshurat e informimit të pacientit për vaksinat, në faqen e internetit www.hpra.ie. Kërkoni për Gardasil 9 (HPV) për të lexuar broshurën përkatëse të informimit të pacientit.